

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

MATERIAL MËSIMOR MBËSHTETËS

PËR

REALIZIMIN E PROGRAMIT TË MODULIT PROFESIONAL

“ETIKA E VESHJES DHE E ARREDIMIT”

Për kurrikulën me zgjedhje të lirë në gjimnaz

Tiranë, 2012

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**MATERIAL MËSIMOR MBËSHTETËS PËR
REALIZIMIN E PROGRAMIT TË MODULIT PROFESIONAL**

“ETIKA E VESHJES DHE E ARREDIMIT”

Përgatiti:

Anila Zajmi Katanolli
Elona Boçe

Redaktimi shkencor:

Dr. Mirela Andoni

Redaktore letrare:

Freskida Miloti

PËRMBAJTJA

1. Udhëzime të përgjithshme për realizimin e modulit	4
2. Udhëzime sipas rezultateve mësimore (RM) të parashikuara në modul	7
1. RM 1: NXËNËSI PËRSHKRUAN ASPEKTE TË ETIKËS SË TË VESHURIT DHE ARREDIMIT	7
2. RM 2: NXËNËSI REALIZON IDE TË THJESHTA PËR VESHJE BAZUAR NË ASPEKTET E ETIKËS SË TË VESHURIT	14
3. RM 3: NXËNËSI REALIZON SKICËN E THJESHTË TË ARREDIMIT TË NJË AMBIENTI BANIMI	15
4. Shtojca	27

1. Udhëzime të përgjithshme për realizimin e modulit

Qëllimi i programit të modulit profesional “Etika e veshjes dhe arredimit”

Ky modul ka për qëllim të njohë dhe aftësojë nxënësit me elementë të thjeshtë bazë të etikës së veshjes dhe arredimit, me qëllim përdorimin në jetën e përditshme dhe për t’u orientuar për shkollimin e mëtejshëm dhe punësim në këto fusha.

Ky material mbështetës jep disa terma, koncepte dhe praktika bazë të etikës së veshjes dhe arredimit. Duke patur si funksion kryesor aftësimin praktik të nxënësve në lidhje me “Etikën e veshjes dhe arredimit” ky material përmban modele të shumta të veprimtarive praktike që duhet të realizojnë nxënësit nën drejtimin e mësuesit.

Teknikat e ndryshme të sugjeruara për zhvillimin e mësimi synojnë krijimin e besimit tek nxënësit, rritjen e entuziazmit, stimulimin e kreativitetit për arritjen e objektivave të parashikuara në modul. Sigurimi i realizimit të rezultateve të parashikuara të të mësuarit do të shërbejë jo vetëm për të aftësuar nxënësit që të planifikojnë veshje dhe arredim mjedisesh në mënyrë krijuese dhe profesionale, por edhe që ata të jenë klientë kërkuar, duke përmbushur një tjetër mision të rëndësishëm të modulit që është aftësimi i nxënësve për jetën.

Struktura e programit të modulit profesional “Etika e veshjes dhe arredimit”

Struktura e programeve të moduleve profesionale në gjimnaz, është modulare e njëjtë me strukturën e programeve të moduleve praktike të arsimit dhe trajnimit profesional, kjo edhe për të krijuar një identitet të tyre në kurrikulën e gjimnazit.

Ky modul përmban 3 Rezultate Mësimore (RM), ku RM1 është i detyrueshëm dhe ka si qëllim njohjen e fushës ku është fokusuar veprimtaria e këtij moduli, si dhe parimet, konceptet dhe termat bazë të etikës së veshjes dhe arredimit.

Ky modul mund të realizohet minimumi me 36 orë. Nxënësit mund

t'i ofrohet që të realizojnë gjithë modulën, duke krijuar mundësi që të fitojë 1 Kredit pas realizimit të tij ose vetëm RM1 dhe RM2 apo RM1 dhe RM3 dhe në këtë rast nxënësi fiton $\frac{1}{2}$ Krediti.

RM 2 dhe RM3 njohin dhe aftësojnë nxënësit për parime dhe aftësi kryesore njëra për etikën e veshjes dhe tjetra për atë të arredimit.

Modeli i programit të modulit e bën atë **shumë fleksibël**, shkolla në varësi të kushteve apo nevojave mund të shtojë dhe zhvillojë sipas dëshirës RM të tjera, si dhe të aftësojë nxënësit me më shumë orë.

Udhëzime didaktike për realizimin e modulit

Për realizimin e modulit mësuesi duhet të planifikojë mësimin, duke mbajtur parasysh rezultatet mësimore të parashikuara në programin e modulit, si dhe të shpjegojë termit dhe konceptet kryesore duke i vënë theksin demonstrimit të hapave për etikën e veshjes dhe arredimit.

Mësuesi duhet të mbikëqyrë nxënësit bazuar në udhëzuesit e përmbushjes së proceduarve të punës si për veprimtaritë individuale ashtu edhe për punët në grup.

Gjatë zhvillimit të mësimit mësuesi sugjerohet të lidhi tematikën dhe aftësinë që trajtohet me përvoja nga realiteti konkret me qëllim që të krijohen kushte për diskutime, debate dhe argumentime dhe ndihmon nxënësit t'i përshtatin lehtësisht njohuritë në praktikë.

Ky material mësimor mbështetës ka përshkrime teorike të termave, si dhe modele të shumta të veprimtarive praktike, me qëllim që nxënësit të ndihen entuziastë dhe të motivuar, si dhe ndihmon nxënësin për të kuptuar mesazhin dhe arritjen e objektivit të të mësuarit.

Sugjerohet që vetëm 20% e përmbajtjes së modulit të jetë e fokusuar te njohuritë, 80% të jetë veprimtari praktike e nxënësve.

Vlerësimi

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i

shkallës së arritjes së shprehive praktike.

Nxënësi mund të vlerësohet nga aktivizimi gjatë orës së mësimi, aktivizimi në punën në grup, në simulimin e roleve, si dhe në prezantimin e detyrave.

Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Vlerësimi për njohuritë teorike të kryhet përmes pyetjeve dhe përgjigjeve me gojë, testit me shkrim, si dhe detyrave apo projekteve të pavarura.

Vlerësimi i aftësive praktike të kryhet përmes vëzhgimit të demonstrimit praktik me listë kontrolli.

2. Udhëzime sipas rezultateve mësimore (RM) të parashikuara në modul

RM 1: NXËNËSI PËRSHKRUAN ASPEKTE TË ETIKËS SË TË VESHURIT DHE ARREDIMIT

Njohuritë mbi etikën e veshjes

Etika e të veshurit përfaqëson prezantimin korrekt të personalitetit të një individi.

Veshja duhet të jetë brenda normave të moshës, mjedisit, grupit shoqëror ku bën pjesë individi etj.

Për realizimin e një veshjeje në përputhje me personalitetin, moshën dhe mjedisin duhen të mbajë parasysh aspektet e mëposhtme:

- proporcioni i veshjes referuar konstruktit fizik dhe personalitetit të individit;
- format, përmasat dhe ngjyrat e veshjes në raport me moshën dhe mjedisin.

Në veshjen e individit ka një ndikim të rëndësishëm stina, momenti i ditës, rasti apo ngjarja. Kjo shprehet në materialet që përbëjnë veshjen dhe kombinimin e ngjyrave.

Veprimtari praktike:

1. Nxënësit hulumtojnë në internet dhe literaturë mënyra të veshjeve në raste të ndryshme, modelet e veshjeve, materialet që e përbëjnë veshjen, raportet me prirjet e modës, veçoritë sipas moshës.
2. Nxënësit prezantojnë evoluimin e veshjeve dhe materialeve që i përbëjnë ato në dekadat e fundit, duke evidentuar veçoritë për çdo periudhë.

Njohuritë mbi etikën e arredimit

Arredimi i një ambienti të brendshëm përbëhet nga një tërësi projektesh të ndryshme, por të lidhura me njëra-tjetrën, të cilat e kthejnë një hapësirë të brendshme në një ambienti funksional për veprimtaritë e jetës së njeriut që duhet të kryhen në të.

Pesë faktorët bazë të arredimit

Para se të fillohet arredimi i çdo dhome, duhet të merren parasysh pesë faktorët kyç ose bazë të cilët janë:

1. Funksioni
2. Ngjyra
3. Ndriçimi
4. Pika kyçe (tërheqëse)
5. Qarkullimi

1. Funksioni

Duhet të kihet parasysh gjithmonë se kush do ta përdorë ambientin, cilat janë nevojat e tyre dhe për çfarë qëllimi përdoret ambienti. Funksionet bazë të çdo dhome janë të thjeshta: dhoma e gjumit duhet të ketë një krevat me përmasë të përshtatshme, komodina ose tavolina të vogla anësore, një gardërobë apo komo për vendosjen e rrobave dhe një karrige ose stol. Këto janë bazë. Mund t'i shtohet një tavolinë pune nëse duhen bërë detyrat, një shportë lodrash, një tavolinë ndërrimi për bebet apo një bibliotekë. E rëndësishme është të mbahet mend se **funksioni** parësor i dhomës së gjumit është të ofrojë një vend për të fjetur dhe se çdo gjë tjetër në dhomë është për të siguruar lehtësinë dhe për ta bërë sa më të rehatshme.

Dhoma e ngrënies duhet të ketë një tryezë me përmasa të mjaftueshme për numrin më të madh të përdoruesve të përditshëm, me mundësi për t'u bërë më e madhe në raste të veçanta. Duhet të ketë karrige të mjaftueshme për përdoruesit e përditshëm dhe karrige shtesë (që mund të ruhen aty ku nuk prishin punë). Këto janë bazë, pasi **funksioni** parësor i kësaj dhome është të ofrojë një vend për të ngrënë ushqimin.

Funksioni i dhomës së ndenjes është për të ofruar një vend për familjen që të mbledhet në kohën e saj të lirë. Këtu mund të ketë hapësirë për të luajtur lojëra, për të parë TV apo për të punuar në kompjuterin e përbashkët. Duhet të ketë vende të rehatshme për t'u ulur.

Ana praktike është po aq e rëndësishme sa edhe estetika e një dhome, nëse duam që ajo të duket bukur dhe të jetë e këndshme për veten dhe familjen. Një dhomë e skicuar dobët është një dhomë që nuk e përmbush mirë **funksionin** e saj.

2. Ngjyra

Ajo që është e rëndësishme për ngjyrën është si ndjehesh kur je duke ndenjur në dhomë. Nëse të pëlqen pamja e mureve të bardha kundrejt

të cilës pikturat në mure rrinë këndshëm, atëherë ajo ngjyrë shkon. Pra, analiza nuk bëhet me mendje, por me ndjenjë, duke qëndruar në qendër të dhomës. Të duket sikur tavani është shumë poshtë? Të duket sikur dhoma është shumë e gjatë, apo shumë e shkurtër? Ngjyra mund të ndryshojë mënyrën si ndjehemi në një dhomë pa ndryshuar gjërat e tjera. Në përgjithësi, ndriçimi dhe ngjyrat e lehta e zgjerojnë dhomën dhe bëjnë që tavani të duket më i lartë. Ngjyrat e ngrohta dhe të errëta e bëjnë një dhomë të duket më e ngrohtë dhe bëjnë që tavani të duket më i ulët.

3. Ndriçimi

Termi “ndriçim” në rrethanat e arredimit të ambienteve të brendshme i referohet dy elementeve që ndikojnë dhomën.

Së pari, është elementi i sasisë së dritës natyrale që hyn në dhomë. Krahu i vendosjes së dritareve përcakton më shumë se çdo gjë, se sa dritë hyn në dhomë. Dritaret në krahun e lindjes lejojnë dritë në mëngjes. Nëse dhoma përdoret kryesisht në mëngjes (për të bërë gati mëngjesin, për të bërë gati fëmijët për në shkollë, për të punuar në tavolinën e punës) atëherë mundohu të marrësh përfitimet e dritës natyrale duke mos vënë perde të rënda në dritare.

Dritaret në anën perëndimore të shtëpisë do të përfitojnë nga ngjyrat e forta të perëndimit të diellit. Dhomat që përfitojnë nga kjo dritë mund të jenë dhoma e ndenjes apo biblioteka. Ngjyrat e ngrohta dhe të plota do të theksohen nga ky ndriçim. Dritaret në krahun verior të shtëpisë preferohen për të bërë punë tryeze. Është një dritë më e qëndrueshme me pak intensitet. Ngjyrat e lehta do të theksojnë sasinë e dritës që ka kjo anë.

Pamja e dritareve nga jugu zakonisht përthith më shumë nxehtësi dhe rreze ultraviolett nga dielli çka mund të ndikojnë veprat e artit, cohët dhe tapetet. Megjithatë, bimët brenda shtëpisë përfitojnë prej saj.

4. Pika kyçe (tërheqëse)

Në një ambient të brendshëm, lëvizja e syrit përqendrohet drejt një pike interesi që është e shqueshme brenda dhomës. Është në natyrën njerëzore të kërkojë një qendër interesi, si një vend për të çlodhur syrin e mendjen dhe për të krijuar rregull në mes të parregullsisë. Pa një pikë kyçe, dhoma duket e çorganizuar, konfuze, ndoshta e ngarkuar dhe deri e mërzitshme.

Nëse hedh vështrimin në një dhomë të caktuar, do të shohësh se dallohet një tipar i natyrshëm që është pika kyçe: oxhaku, pamja nga

dritarja, një bibliotekë me TV në mes, piano, krevati. Nëse pika kyçe ekzistuese në dhomë nuk ju tërheq shumë, atëherë mund të mendohet për një pikë kyçe sekondare për ta balancuar atë.

5. Qarkullimi

Duhet të mendohet si është vendosur çdo pajisje/mobilie për të siguruar që çdokush lëviz në mënyrë të lirshme në dhomë apo përreth saj.

Përgatitja për arredimin

Për të bërë gati arredimin e shtëpisë ose ambientin është e nevojshme të merren parasysh prioritetet, buxheti, të hartohet skica, si dhe të përgatitet lista e pajisjeve dhe mjeteve që duhen.

Çfarë dëshiron të bësh?

- Bëhen pyetjet: Çfarë do të doje të ndryshoje në dhomë apo në dhoma? Ngjyrat? Pajisjet? Të krijosh më shumë mundësi për sistemimin e gjërave?
- Bëhet një listë me objektiva që janë të arsyeshme për t'u realizuar.
- Kalohen me radhë objektivat për t'i parë cilat janë ato që s'kanë kosto, si p.sh. ndryshimi i vendosjes së mobilie, veprave të artit etj.
- Përcaktohen prioritetet e tjera dhe buxheti.

Përgatitja e skicës

Skica fillon duke matur përmasat e hapësirës në dhomë. Më pas, bëhet një skicë e dhomës në letër. Është mirë të përdoret fletë me kutia duke caktuar p.sh. 2 kuti për çdo 1 metër gjatësi. Më pas, maten pajisjet/mobilitet, skicohen në letër dhe priten në përmasa proporcionale me ambientin e dhomës. Caktohet pika kyçe të dhomës dhe përfytyrohet si do të ishte qarkullimi për çdo lloj kombinimi që u bën mobilie. Në fillim vendosen në skicë mobilitet më të mëdha. P.sh. duke pasur oxhakun si pikë kyçe, kombinimet mund të jenë dy kolltukë dyshe paralele në çdo anë të oxhakut ose një divan përballë oxhakut dhe një tavolinë mesi; ndërkohë që nëse si pikë kyçe është TV kombinimi mund të jetë një set divanesh me pamje nga TV. Vazhdohet duke shtuar pajisjet më të vogla si: tavolina, tavolina anësore, tavolina pune etj.

Buxheti

Buxheti është i rëndësishëm për të përcaktuar llojin dhe përmasën

e ndryshimit që do të bëhet në ambient. Kjo gjë duhet patur parasysh që në fillim të planifikimit të arredimit.

Dyshemetë

Lloji më i përshtatshëm i dyshemesë zgjidhet në përputhje me stilin e familjes, buxhetin dhe faktorët e tjerë të përmendur më sipër. Zakonisht, ndryshimi i dyshemesë bën pjesë në një projekt arredimi ku përfshihen ndryshime të thella të banesës. Llojet më të zakonshme të dyshemeve janë:

1. Pllakë
2. Gur
3. Granil
4. Laminat

Veshjet e dritareve (perdet)

Kur flitet për veshjet e dritareve duhet menduar për privatësinë, pamjen, ndriçimin që hyn dhe ruajtjen e energjisë. Nëse nga dritarja ka pamje të bukur, duhet të vendosen perde që lejojnë pamjen. Në dritaren e dhomës së gjumit mund të duhen perde që errësojnë dhomën për të mos lejuar hyrjen e dritës së mëngjesit. Dhomat e errëta kanë nevojë për perde që lejojnë dritën. Perdet bëjnë të mundur që dhoma të rrijë më e ngrohtë në dimër dhe më e freskët në verë.

Pasqyrimi i stilit personal

Dhoma apo shtëpia duhet të pasqyrojë shijen dhe personalitetin e banorëve. Për ta bërë këtë, ndihmojnë aksesorë të ndryshëm, veprat e artit, koleksionet e ndryshme dhe bimët.

Aksesorët

Me aksesorë kuptohen copat, abazhurët, bimët, qilimat, mbulesat, madje edhe pajisjet e kuzhinës. Për aksesorët duhet të zgjidhen ngjyra që janë dy tonalitete më të forta apo më të buta se ajo e murit. Nëse dhoma e fëmijëve është me ngjyra primare (të kuqe, blu, të verdhë) atëherë mund të përdoren ngjyrat e ngrohta të vizatimeve për t'i dhënë theks. P.sh. muret e verdha, kutia e kuqe e lodrave, qilimi blu dhe mbulesa jeshile e krevatit shkojnë shumë mirë së bashku.

Nëse ngjyra bazë është neutrale (p.sh. bezhë) atëherë e zeza i jep theks shumë të përshtatshëm. P.sh. mund të dekorohet me imazhe kafshësh në ngjyrë të errët.

Për aksesoret mund të përdoret edhe qasja monokromatike, pra të përdoren ngjyra brenda të njëjtës familje apo vetëm një ngjyrë komplementare. P.sh. mund të lyhen muret me ngjyrë rozë të theksuar, perdet me ngjyrë të kuqe dhe panë, jastëkë me ngjyrë të kuqe dhe panë dhe mokat me ngjyrë panë.

Një mënyrë tjetër është të përdoren tonalitete të ndryshme të së bardhës brenda dhomës së gjumit, me mure të bardhë, mbulesa ngjyrë kremi dhe mobilie të lyera në ngjyrë pana.

Është mirë të zgjidhet copë njëngjyrëshe për ndenjëset (divanet p.sh.) nëse muret janë me trajta. Nëse ndenjëset e divaneve janë me trajta, atëherë duhet zgjedhur një qilim me njëngjyrësh ose me trajta jo fort të shqueshme për të shkuar më së miri me to. Sigurisht këto nuk janë rregulla strikte, por në përgjithësi, nëse ka shumë trajta që përplasen me njëra-tjetrën, krijohet konfuzion dhe kaos për vëmendjen.

Rëndësia e veprave të artit

Një nga mënyrat më domethënëse për ta bërë dhomën të ketë vulën tuaj personale është duke shtuar vepra të artit. Mund të ekspozohen foto dhe pamje nga momentet e jetës së familjes. Fotot bardhë e zi duken shumë mirë në korniza të zeza ose argjendi dhe në fusha të bardha. Mund të vendosen mbi oxhak ose në një vend ku zakonisht mblidhen njerëz.

Guaskat, gjethet apo objekte të tjera nga natyra mund të vendosen në korniza. Një fustan i vjetër fëmije, i trashëguar nga familja, një dokument me rëndësi për familjen, mund të vihen në kornizë dhe në mur.

Pamjet mund të zhvendosen në vende të ndryshme me kalimin e kohës.

Ekspozimi i koleksioneve

Shfaqja e koleksioneve i jep më shumë formë stilit tënd personal të shtëpisë, sigurisht duke ruajtur masën. Për të shfaqur ato, përdoret parimi i numrit tek (tre, pesë etj). Objekti më i gjatë vendoset në fund dhe pjesët më të shkurtra në fillim. Në një tavolinë, objekte të tilla vendosen nga më i gjati në mes, tek më të shkurtrit anash. Ndryshe mund të vihen tri objekte në një anë dhe një tjetër, më i shqueshëm prej tyre, në anë të kundërt. Nuk është nevoja të përkujnë, por duhet të krijojnë harmoni në pamje.

Dollapët në qoshe të dhomave (në formë këndi) mund të shërbejnë si një mënyrë për të ekspozuar gjërat dhe shpesh, edhe si pika kyçe sekondare.

Ekspozimi i librave është gjithashtu një gjë e mirë për të shtuar ngjyra dhe përbërje në dhomë, si edhe për të shfaqur shijen tënde në lexim.

Sill natyrën brenda

Një bimë e madhe shkon mirë në një cep të zbrazur, sidomos nëse plotëson dekorin e dhomës. Kaktuset e plotësojnë një tavolinë mesi (vetëm në rast se nuk ka fëmijë të vegjël në lëvizje), në raft apo një tryezë pranë dritares. Një bimë Bonsai i jep një pamje tradicionale një dhome dhe një bimë bamboje në miniaturë të sjell një ndjesi aziatike. Një dekorim me lule të thata ose një shportë me fruta mund të përdoren si zëvendësuese të bimëve të gjalla.

Sugjerime për zhvillimin e mësimi

Mësimi i njohurive zhvillohet duke u ofruar nxënësve leksione të shkurtra të shoqëruara me diskutime dhe pyetje.

Sugjerime për vlerësimin

Mësuesi/ja mund të përdorë vlerësimin me anë të testit.

RM 2: NXËNËSI REALIZON IDE TË THJESHTA PËR VESHJE BAZUAR NË ASPEKTET E ETIKËS SË TË VESHURIT

Skicimi dhe përzgjedhja e veshjes për një rast të veçantë (ditëlindje, mbrëmje mature, ekskursion etj).

Qëllimi i veprimtarisë: nxënësi të krijojë një skicë të thjeshtë për veshjen apo aksesorët.

Hapi i parë:

Përzgjedhja e ngjarjes nga nxënësit.

Hapi i dytë:

Skicimi i veshjes dhe aksesorëve, duke mbajtur parasysh ngjarjen, stinën, moshën.

Hapi i tretë:

- Përzgjedhja e materialeve (pëlhurës dhe aksesorëve) në rastin kur përgatitet nga vetë nxënësi apo kur realizohet në një rrobaqepësi;
- Përzgjedhja e veshjes në treg referuar konceptit të krijuar nga nxënësi.

RM 3: NXËNËSI REALIZON SKICËN E THJESHTË TË ARREDIMIT TË NJË AMBIENTI BANIMI

Veprimtari praktike: Krijimi i projektit të arredimit

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësi të krijojë një projekt të thjeshtë arredimi.

Mjetet e nevojshme:

Fleta e udhëzimeve për nxënësin, fleta e punës me detajet e projektit për t'u mbushur individualisht nga nxënësi.

Udhëzime për nxënësin:

Hapi i parë: Mblidh sa më shumë të dhëna të detajuara për familjen dhe shtëpinë ku jeton familja (mund të jetë edhe familja jote). Këto të dhëna do të nevojiten për të kuptuar çfarë lloj arredimi i përshtatet më mirë asaj familjeje. Ato përfshijnë adresën, numrin e dhomave, numrin e anëtarëve të familjes, nëse mbajnë apo jo kafshë shtëpiake, cila është mënyra e jetesës së tyre (janë tipa profesionalë, të thjeshtë, pensionistë, persona që punojnë nga shtëpia, adoleshentë me shumë shokë e shoqe, të dhënë pas kafshëve shtëpiake), stilin aktual të shtëpisë, llojin e ndërtimit ose banesës, buxhetin që kanë ata në dispozicion për të përdorur në arredim, përmbajtjen e përgjithshme të projektit (p.sh. arredimi i kuzhinës).

Hapi i dytë: Merr me radhë çdo të dhënë dhe zgjeroje. P.sh. e dhëna për anëtarët e familjes: sa janë? Çfarë moshash kanë? Cilat janë nevojat dhe kërkesat e tyre? Kjo është e rëndësishme për të përcaktuar hapësirat që u nevojiten p.sh. në tualet (dush apo vaskë etj.) Nëse stili aktual i shtëpisë është një stil me mobilie të regjimit komunist të ndërtuara në vitet 1980, çfarë lloj stili do të donin ata ta kishin tani? Do të arrihet e gjithë shtëpia nga e para apo vetëm një pjesë e saj? Do të shihet nëse plani i familjes janë për të bërë ndryshime që do të zgjasin në kohë apo ndryshime të përkohshme. Do të përcaktohet nëse bëhet fjalë vetëm për ndryshim të pajisjeve dhe mobilieve apo edhe mureve, banakut të kuzhinës etj.

Hapi i tretë: Përcaktohet buxheti i kësaj ndërhyrjeje për arredim. Ndryshimet do të jenë sa më realiste të mundën në përputhje me buxhetin që familja ka në dispozicion. Në këtë rast, bëhet një listë e atyre gjërave që kanë më shumë përparësi dhe që familja do që t'i bëjë patjetër.

Hapi i katërt: Përcaktohet lloji i ndërhyrjes që do të bëhet. Çfarë dëshiron familja që të bëhet në shtëpinë e saj? A do të jetë një ndryshim i tapeteve, perdeve dhe pajisjeve të thjeshta apo një ndërhyrje më e madhe deri në ndërtim të mureve të reja, zgjerim hapësirash dhe ndryshim i kapakëve të bufesë së kuzhinës? Bëhet një listë me gjërat, të cilat arreduesi (në këtë rast nxënësi) do që të arrihen, ndryshimet që kërkohen dhe vendet/dhomat ku do të ndodhin, dhe burimet që do të përdoren.

Hapi i pestë: përcaktimi i stilit të jetës së familjes. Përpara se të fillohet puna për arredimin, duhet të kuptohet si e përdorin çdo ditë shtëpinë personat që banojnë në të. P.sh. në një familje me fëmijë të vegjël dhe bebe, do të ishte e pavend të kishte një kuzhinë me sipërfaqe të bardha dhe të lëmuara, nëse familja kalon shumë kohë duke gatuar për ta. Do të duhej një kuzhinë me hapësira të lehta për t'u përdorur dhe kollajti për të gjetur atë që duhet. Në një familje me disa adoleshentë, do të duhej një hapësirë me frigorifer voluminoz, pasi ata janë në moshën që duhet të ushqehen!

Hapi i gjashtë: Estetika e projektit. Në çfarë stili do të donte familja ta kishte këtë arredim?

Sugjerime për zhvillimin e mësimi

Veprimtaria nr. 1 mund të kryhet individualisht dhe në punë në dyshe. Nxënësit i kërkohet të ndjekë udhëzimet dhe të plotësojë individualisht (në shtëpi) fletën e punës me detajet e projektit të arredimit.

Në orën e ardhshme, nxënësit ndahen në grupe dyshe dhe ftohen që të prezantojnë me radhë tek njëri-tjetri projektin që kanë bërë, si edhe t'i bëjnë pyetje njëri-tjetrit.

Sugjerime për vlerësimin

Veprimtaria nr. 1 mund të vlerësohet nëpërmjet vetëvlerësimit ose vlerësimit nga shoku.

Veprimtari praktike: Zbulimi i stilit të arredimit (*opsionale – për nxënëës më të avancuar*).

Qëllimi: Nxënësi të zbulojë cili është stili i arredimit që i përshtatet familjes së tij/saj.

Mjetet e nevojshme: Fleta e punës së projektit që ka krijuar nxënësi në veprimtarinë nr. 1, revista, foto të ambientit që do të arredohet, libra, ilustrime.

Udhëzime për nxënësin:

1. Duke patur parasysh projektin që ke krijuar në veprimtarinë e parë, hidh disa ide, skicoji këto ide ashtu siç të vijnë, hap revista ose libra për t'u njohur me stile të mundshme të arredimit, të cilat do të të ndihmojnë të kuptosh cili është ai që ndjehesh më rehat. Mund të shohësh modele ngjyrash, copash dhe materialesh që të krijosh ide, mund të shohësh foto aktuale të ambientit që do të arredohet. Fillo t'i bësh gjërat bashkë në mënyrë spontane, ashtu siç të vjen. Kjo gjë bëhet derisa nuk ke më ide për të hedhur. Më pas, ndërprite punën dhe vazhdoje më vonë.
2. Kthehu në dhomën që do të arredohet dhe shih se çfarë të bën përshtypje ose të tërheq syrin në fillim. Bëji pyetje vetes pse ta tërhoqi syrin. A duhet të jetë kjo gjë pjesa kyçe e dhomës, a duhet të qëndrojë ende siç është? Nëse përgjigjet janë po, atëherë vazhdo me gjërat e tjera që ka aty brenda, si edhe me aksesoret që ndodhen në të. Më pas, kthehu te projekti dhe fillo të merresh me idetë që të kanë ardhur. Kjo është një fazë ku eksperimentohet me shtëpinë, pa e dekoruar atë vërtet. Thjesht krijohet ideja se si mund të jetë.
3. Hapi i fundit i kësaj veprimtarie është të përfytyrosh se si do të duket dhoma ose ambienti. Këtë mund ta bësh me skicë të vizatuar në letër ose të krijuar në kompjuter.

Sugjerime për zhvillimin e mësimi

Veprimtaria nr. 2 mund të zhvillohet në dy pjesë.

Pjesa e parë është puna individuale e nxënësit në shtëpinë e tij, për të krijuar idenë e stilit të arredimit.

Pjesa e dytë mund të jetë një punë në grup në klasë, ku nxënësit ftohen të zgjedhin projektin e njërës prej nxënësve të grupit dhe ta diskutojnë atë. Pyetjet të cilat ata mund t'i përgjigjen janë:

- Çfarë rruge ka ndjekur nxënësi për ta zbuluar stilin?
- A mungon ndonjë aspekt i rëndësishëm?
- Çfarë është pozitive në projektin e tij?

Sugjerime për vlerësimin

Njësoj si në veprimtarinë nr. 1, edhe veprimtaria nr. 2 mund të vlerësohet nëpërmjet vetëvlerësimit (listë kontrollit) apo vlerësimit në grup.

Veprimtari praktike: Si të përdoret ngjyra në mënyrë të saktë

Qëllimi: Nxënësi është në gjendje të përzgjedhë në mënyrë harmonike ngjyrat gjatë arredimit të ambientit.

Mjetet e nevojshme: Skema e ngjyrave (e plotë), skema e ngjyrave primare dhe skema e ngjyrave sekondare.

Udhëzime për nxënësin:

1. Gjithmonë fillo me një ngjyrë të vetme për të krijuar spektrin e ngjyrave për ambientin që do të arredohet. Ajo ngjyrë mund të jetë kudo: në një vepër arti, në një rrugicë, në një copë divani, në një dekorim prej lulesh. Nëse arredimi do të bëhet nga fillimi, filloje duke planifikuar nga baza, pra duke u ngjitur nga dyshemeja-lart.
2. Vendos për spektrin e ngjyrave që do të përdorësh.
3. Vendosi ngjyrat me mend në pjesët më të mëdha të dhomës: dysheme, mure dhe tavan.
4. Vendos ngjyrat edhe në pjesët e tjera të dhomës: pajisje, mobilie, karrige etj. Duhet patur parasysh parimi i balancës. Nuk duhen grupuar të njëjtat ngjyra në një zonë, por duhen shpërndarë aty-këtu, në mënyrë që të jetë e lehtë për syrin.
5. Ndërsa je duke përfytyruar dhe planifikuar ngjyrat, mendo gjithmonë në të tri dimensionet. Marrim një shembull: perdet e errëta e bllokojnë dhomën, por nëse ruhet i njëjti tonalitet i perdeve edhe në mure, atëherë hapësira do të duket më e hapur. Ngjyra e errët e dyshemesë është përcaktuese për spektrin që do të përdorësh. Për të krijuar një ndjenjë të rehatshme dhe personale, përdor ngjyra të errëta dhe të ngrohta, për të krijuar dritë dhe hapësirë duhet përdorur e kundërta, pasi ngjyrat e zbehta, të freskëta dhe të ftohta e zmadhojnë dhomën dhe e bëjnë të ndjehet e freskët. Një tavan i lyer me ngjyrë të errët e zvogëlon lartësinë e dhomës, por ndodh e kundërta nëse përdor të bardhën. Ngjyra mund të përdoret për t'i dhënë edhe formë tjetër dhomës, nëse i lyen faqet me ngjyrë të ndryshme ose eksperimenton me format që i jep ngjyrave në mure.

6. Është e rëndësishme të testosh ose të provosh se si duket ngjyra duke marrë një kampion të saj dhe duke e vendosur në mur ose në copën e pajisjeve. Kjo të ndihmon të shohësh si do të dukej ajo në realitet, dhe në kohë të ndryshme të ditës, kur edhe ndriçimi është ndryshe.
7. Duhet të kesh parasysh që dhoma të jetë në harmoni edhe me pjesën tjetër të shtëpisë.
8. Duhet të kesh parasysh gjithashtu ndriçimin që ka dhoma dhe si do të ndikojë kjo në mënyrën si duket ngjyra.

Sugjerime për zhvillimin e mësimi

Veprimtaria nr. 3 mund të zhvillohet si një punë grupi në ambientin e klasës. Mund të zgjidhet një ambient i shtëpisë së njërit prej nxënësve dhe mund të punohet mbi të, duke skicuar skemën e ngjyrave që do të përdoret.

Sugjerime për vlerësimin

Veprimtaria nr. 3 mund të vlerësohet nëpërmjet një listë kontrolli të përdorur nga mësuesi/ja.

Veprimtari praktike: Përdorimi i veshjeve për shtëpinë (copat, perdet, aksesoret)

Qëllimi: Nxënësi të përdorë në mënyrë harmonike veshjet për shtëpinë (copat, perdet, aksesoret).

Mjetet për t'u përdorur: kampione veshjesh dhe copash për shtëpinë (nxënësit mund të sjellin nga shtëpitë e tyre), foto perdeshe, jastëkësh dhe aksesorësh të tjerë për shtëpinë, faqe interneti me modele veshjesh për shtëpinë.

Udhëzime për nxënësin:

Ngjyra e bashkuar me copën e duhur çon në një arredim me hijeshi. Copat kanë përdorime të shumta, disa thjesht estetike, të tjerat thjesht funksionale. Perdet janë një nga mënyrat funksionale të përdorimit të copës. P.sh. përdorimi i perdeve të trasha zvogëlon hyrjen e ajrit, mban nxehtësinë brenda dhomës, zvogëlon zhurmat në dhomë dhe i jep një pamje të bukur dhomës.

Copat përdoren gjithashtu për kolltukë dhe divane. Kjo ka edhe vlerën funksionale, por edhe atë të rehatisë, sidomos nëse janë të ngrohta dhe mikpritëse në pamje.

Lloji i copës të krijon menjëherë lidhjen me stilin e arredimit të shtëpisë.

Perdet

1. Për të zgjedhur copën për dritaret (perdet), duhet parë me sy gjysmë të mbyllur, pasi kështu mund të shihen ndryshimet në tonalitet dhe përbërje të copës, si edhe shkëlqime të mundshme të saj. Gjithashtu, duhet mbajtur në mënyrë vertikale për të parë se si rri e derdhur, duhet parë pesha e saj dhe pamja. A mund të shihet përmes saj? A krijon valëzime? Çfarë lloj valëzimesh? A është e përshtatshme për perde? A është ngjyrë që reziston apo që zbehet? Copat sintetike kanë një prirje për t'i rezistuar më shumë zbehjes nga dielli, ndryshe nga copat me fibra natyrale si mëndafshi, linoja dhe leshi.
2. Shiko format e copës, a do të duken nëse bëhet perde apo do të humbasin efektin? Format ose trajtat e mëdha në dritare, e bëjnë dhomën më të vogël. Duhet pasur parasysh përmasa e dhomës kur zgjidhen trajtat që ka copa. Por nëse trajtat janë të vogla, ato do të dukeshin jashtë proporcioneve në një dhomë të madhe. Nëse do të përdorësh skemën monokromatike të ngjyrës, atëherë zgjidh një copë perdeshe e cila është një ose dy tone më të hapura ose më të errëta sesa ngjyra e murit, pasi kjo krijon një kontrast të mjaftueshëm. Por, duhet patur parasysh që lloji i copës të jetë i veçantë në këtë rast, pasi ndryshe, kjo skemë e ngjyrave (monokromatike) mund ta bëjë dhomën të duket e sheshtë.
3. Zgjidh me kujdes llojin e kornizës së perdes, pasi kjo do të përcaktojë si do të varet copa dhe nëse ajo do të shpaloset apo do të fshihet.
4. Perdet e derdhura krijojnë një pamje më të zbutur dhe romantike në dritare, ndryshe nga perdet e varura me valëzime, të cilat krijojnë më shumë luks dhe ngrohtësi.

Aksesorët

1. Aksesorët janë pjesa e argëtimit me copat. Kështu copa mund të përdoret si aksesor, për të çelur një skemë ngjyrash të zbehura, apo për t'i shtuar dhomës pak kolorit stine. Jastëkët janë një mënyrë shumë e njohur për ta bërë këtë. Mund të përdoret e njëjta copë si ajo e perdeve,

por në një ngjyrë tjetër, për t'i shtuar një dimension tjetër dhomës, duke patur parasysh që të përdoren këto trajta më shumë se një herë në dhomë për të krijuar një pamje të mirë. Mund të zgjidhet një ngjyrë e përdorur në perde dhe të përdoret për t'i dhënë më shumë theks. Është e rëndësishme të mbahet mend që copa përdoret për të shtuar më shumë përbërje dhe zbutje në dhomë, por edhe për t'i shtuar ngjyra dhe krijimtari skemës, si edhe për të theksuar stilin që ke krijuar.

2. Një arsye për të përdorur copat për aksesoret në dhomë është se ato përthithin tingujt. Kjo do të thotë se dhoma e ndenjes nuk do të krijojë jehonë zëri kur ndez magnetofonin, nëse ka mobilie dhe pajisje të veshura në dhomë. Për të provuar që kjo është e vërtetë, qëndro në tualet, pa pasur as peshqirë as copa të tjera të buta përqark dhe ndiz radion. Më pas, provoje duke shtruar copat thithëse në dyshtet e tualetit dhe ndize sërish radion. A vihet re ndryshimi?

Sugjerime për zhvillimin e mësimi

Nxënësit mund të vihen në punë grupi për të përzgjedhur nga fotot ose kampionet e veshjeve për shtëpinë të sjella në klasë ato më të përshtatshmet për stilin e arredimit të një dhome. Dhoma mund të jetë nga shtëpia e njërit prej anëtarëve të grupit.

Sugjerime për vlerësimin

Mund të përdoret vetëvlerësimi ose vlerësimi në grup.

Veprimtari praktike: Vendosja e pajisjeve/mobilieve dhe hapësira

Qëllimi: Nxënësi është në gjendje të vendosë pajisjet/mobiliat në mënyrë harmonike dhe duke respektuar parimet e hapësirës.

Mjetet e nevojshme: Gërshërë, tabakë letre, lapsa, markera.

Udhëzime për nxënësin:

Gabimi më i zakonshëm në vendosjen e pajisjeve është vendosja e tyre rreth e qark mureve, duke menduar se kjo e bën dhomën të duket më e madhe. Kjo teori është e pasaktë dhe bën të kundërtën, pasi e bën dhomën të duket më e vogël dhe më pak e përdorshme.

Një gabim tjetër në arredim është grupimi i të gjitha pajisjeve rreth

një pike kyçe, (çka është e nevojshme ndonjëherë), shpesh kjo pikë kyçe është televizori! Kjo bën që të neglizhohen pamje të tjera të bukura ose pjesë si oxhaku.

Një gabim tjetër i shpeshtë është të mbushet çdo cep me pajisje. Sa më pak, aq më mirë është kur bëhet fjalë për arredim.

Pajisjet/mobiliet duhet të jenë në proporcion me përmasat e dhomës. Një divan ekstra i madh mund të jetë i rehatshëm, por nëse është e vetmja gjë që zë dhoma, atëherë s'është në proporcion me përmasat e saj. E njëjta gjë mund të thuhet për lartësinë e mobilieve. Nëse ke një dhomë të lartë, mobiliat e larta e bëjnë të duket e lartë. Gjithashtu një divan i madh dhe një tavolinë mesi e vogël, janë jashtë proporcioneve, kështu që para se të blihen duhet parë se si shkojnë mobiliat me njëra-tjetrën.

Si t'i bëjmë hapësirat funksionale?

1. Mos u nxito. Bëj pak e nga pak. Si fillim vendos se çfarë do të bësh në atë hapësirë: do të lexosh, do të shohësh TV, do të flesh, do të bësh ushtrime, do të relaksohesh apo do të luash. Më pas, përcakto çfarë të duhet për të bërë këto gjëra p.sh. për dhomën e ndenjes të duhen mobilie për të parë TV, divane, karrige, tavolinë mesi ose tavolina anësore (taketuke) për të mbajtur telekomandat, jastëkë, shporta lodrash, bibliotekë.
2. Vizato në letër si mund t'i vendosësh të gjitha këto pajisje në dhomë, duke pasur parasysh hyrje-daljet (qarkullimin) e njerëzve në dhomë (p.sh. të mos kalojnë para TV sa herë dalin nga dhoma), duke orientuar pajisjet në drejtimet e duhura. Duhet matur dhoma dhe të gjitha pajisjet mund të bëhen në përmasa proporcionale, duke i prerë në forma të vogla. Më pas mund të luhet me to duke i vendosur në mënyra të ndryshme brenda hapësirës së "dhomës".
3. Grupo divanet dhe karriget paralel me njëra-tjetrën nëse do që njerëzit të bisedojnë me njëri-tjetrin. Është më e këndshme për syrin kur pajisjet vendosen paralel me muret.
4. Një hapësirë të caktuar i jepet më shumë theks nëse vendoset një veshje për dyshtim p.sh. një qilim poshtë tavolinës, divaneve dhe karrigeve.
5. Mbajti të gjitha pajisjet elektrike në një zonë të caktuar (TV, magnetofon, video, dvd etj.) pasi kështu zvogëlohen kabllot nëpër këmbë. Nëse është e mundur përdor një mobilie për t'i mbledhur të gjitha. Fonia është mirë që të jetë e ngjitur në mure, pasi kështu

nuk ngatërrohet nëpër këmbë.

6. Mendo se si të krijosh atmosferë në dhomë dhe ndriçimi është i rëndësishëm për këtë. Llambat dhe abazhurët shërbejnë shumë për këtë. Si mund të vendosen ato? Abazhurët e gjatë shkojnë më mirë në cepa pasi e bëjnë dhomën të duket më e madhe, abazhurët e vegjël janë të përshtatshëm për tavolina anësore në krah të divaneve apo kolltukëve, pasi të ndriçojnë nëse do të lexosh apo të bësh ndonjë punë dore. Abazhurët skulpturë janë një pikë kyçe (tërheqëse) dhe mund të vihen kudo.
7. Çdo dhomë duhet të ketë një pikë kyçe (tërheqëse). Duhet të ketë diçka tërheqëse që e kap syri sapo hyhet në dhomë dhe që të bën të duash të jesh në atë dhomë. Disa kanë shtëpi me një pamje shumë të bukur nga dritarja ose ballkoni, por pjesa më e madhe duhet ta krijojnë vetë këtë pikë. Mënyra më e zakonshme për të arritur një pikë kyçe është përdorimi i një vepre arti (skulpturë apo pikturë). Disa mënyra të tjera janë duke përdorur një pasqyrë dekorative të madhe, një oxhak, duke përdorur një ndryshim në ngjyrën e murit, duke përdorur një ndryshim në llojin e letrës së murit apo copës që përdoret për të tërhequr syrin. Ndonjëherë edhe mobilja ose thjesht qilimi mund të jetë një pikë kyçe (tërheqëse), por këto shpesh nuk janë të dukshme pasi syri duhet të shohë poshtë për t'i gjetur, ndërkohë që vendi më i mirë për pikën kyçe është në nivelin e shikimit. Pika kyçe duhet të theksohet edhe me ndriçimin e duhur.

Sugjerime për zhvillimin e mësimit

Nxënësit vihen në punë me grupe për të skicuar dhomën dhe për të dizenuar mobilet/pajisjet në përmasa proporcionale. Më pas, ata i presin në forma të vogla dhe arredojnë dhomën në mënyra të ndryshme derisa gjejnë atë që u përshtatet më shumë.

Sugjerime për vlerësimin

Mësuesi/ja përdor listkontrollin për të bërë vlerësimin e punës në grup.

Veprimtari praktike: Përdorimi i rifiniturave në dhomë

Qëllimi: Nxënësit të përdorin në mënyrë harmonike rifiniturat për arredimin e dhomës.

Mjete të nevojshme: Foto nga ambientet e shtëpive.

Udhëzime për nxënësin:

1. Veprat e artit – piktura ose imazhe. Përzgjidh fotot apo imazhet që lidhen me temën apo stilin që ke zgjedhur, sigurohu që ato brendësojnë ngjyrat nga skema e ngjyrave që ke zgjedhur. Ato mund të përdoren për të theksuar ngjyrat apo për të krijuar një përbërje në mur me tonalitet ngjyrash të ngjashëm. Nëse ke shumë piktura, është mirë të grupohen për të krijuar një pikturë “të vetme”, më tepër sesa t’i shpërndash nëpër mur.
2. Veprat e artit – skulptura. Skulptura është një mënyrë shumë e mirë për të krijuar një pikë kyçe në dhomë, ndaj gjej një pikë të përshtatshme për ta shfaqur atë dhe sigurohu që ka mjaftueshëm ndriçim.
3. Vazot – lulet, të freskëta ose artificiale. Ato janë një mënyrë shumë e mirë për të zbutur ambientin. Lulet e freskëta janë shumë të mira pasi mund të krijosh një pamje të re në varësi të llojit të lules dhe mënyrës si janë vendosur. P.sh. lulet e egra të grupuara sugjerojnë rastësi, tulipanët në vetvete sugjerojnë thjeshtësi, trëndafilat në qendër të dhomës sugjerojnë pasion, lulet e pranverës pasqyrojnë gëzim me ndryshimin e stinës, zambakët e mëdhenj të bardhë shprehin mirëqenie. Për të kursyer kohë dhe para, lulet artificiale janë gjithashtu një opsion i mirë. Ato duken si të gjalla.
4. Jastëkët – Janë një aksesori shumë i mirë, sidomos në shtëpi me fëmijë, pasi kanë dëshirë të luajnë me to! Ato shërbejnë për të theksuar ngjyrat dhe copat që ke përzgjedhur. Mund të përdoret e njëjta copë si ajo e veshjeve të tjera, por me ngjyrë tjetër ose me të njëjtën ngjyrë dhe dizajn tjetër. Ngjyrat me kontrast i japin dritë ambientit. Format dhe pamjet e jastëkëve janë nga më të ndryshmet dhe me to mund të eksperimentohet pafund. Janë një domosdoshmëri për pothuajse çdo dhomë.
5. Mbulesat, batanijet – janë një mënyrë e thjeshtë për ta bërë dhomën të bëhet më e këndshme. Janë të mira nëse ulesh para zjarrit për të lexuar një libër dhe i hedh në shpatulla ose mbështillesh me to. Janë të dobishme për t’i përdorur që të shtohet ngjyrë, përbërje dhe stil në dhomë.
6. Fjongot e perdeve – këto aksesore perdesh i shtojnë shumë stil veshjeve të dritareve.
7. Abazhurët – folëm për to në pjesën e vendosjes së mobilieve, por është e rëndësishme të theksohet se ato krijojnë mundësi për

atmosferë në dhomë. Mund të zgjidhet nga një varietet shumë i madh formash dhe fuqie ndriçuese.

8. Tavolina e mesit – tavolina e mesit i bën njerëzit të ndjehen të mirëpritur në shtëpi.
9. Ornamentet – këto duhen mbajtur në minimum, pasi mbledhin pluhura dhe krijojnë rrëmujë, por nëse janë të vendosura në mënyrë strategjike, e bëjnë shtëpinë të duket mikpritëse dhe e veçantë.
10. Pasqyrat – janë një mënyrë e thjeshtë për t'i bërë dhomat të duken më të mëdha ose për të sjellë më shumë ndriçim pasi drita reflektohet. Mund të eksperimentohet me korniza të ndryshme dhe të bukura për t'iu përshtatur stilit.

Sugjerime për zhvillimin e mësimi

Nxënësit vihen në punë me grupe për të skicuar dhomën dhe për të dizenuar atë me aksesoret përkatës. Ata i presin aksesoret në forma të vogla dhe arredojnë dhomën në mënyra të ndryshme derisa gjejnë atë që u përshtatet më shumë.

Sugjerime për vlerësimin

Mësuesi/ja përdor listkontrollin për të bërë vlerësimin e punës në grup.

Model listkontrolli për vlerësimin e aftësive praktike

Nr.	DETYRAT (SIPAS HAPAVE TË PROCEDURËS SË PUNËS)	PO	JO
1	A mbledhi informacion të detajuar për personat që banojnë në atë ambient përpara se të bëjë planin e arredimit?		
2	A bëri përcaktimin e stilit të jetës së banorëve?		
3	A e mori parasysh informacionin e mbledhur për banorët gjatë përgatitjes së planit të arredimit?		
4	A mori parasysh buxhetin në dispozicion gjatë përgatitjes së planit të arredimit?		
5	A i ka marrë parasysh të tri dimensionet gjatë arredimit?		

6	A ka përcaktuar spektrin e ngjyrave që do të përdoret gjatë arredimit?		
7	A ka marrë parasysh harmoninë ndërmjet arredimit të këtij ambienti me atë të pjesës tjetër të shtëpisë?		
8	A i ka zgjedhur aksesoret në proporcion me elementet e tjera të ambientit?		
9	A i ka zgjedhur pajisjet/mobiliet në proporcion me përmasat e ambientit?		
10	A ka menduar zgjidhje për t'i bërë hapësirat funksionale?		
11	A ka përzgjedhur për ambientin një pikë kyçe, tërheqëse?		
12	A ka marrë parasysh qarkullimin sa më të lirshëm të njerëzve në ambient?		

Shtojcë 1. Fletë pune (Veprimtaria nr.1):

Detajet e projektit të arredimit

Titulli i projektit: _____

Familja/adresa: _____

Nr i dhomave: _____ Nr i anëtarëve të familjes: _____

Informacion për secilin anëtar

(mund të shtohen aq rreshta sa anëtarë janë):

<i>Anëtari i familjes</i>	<i>Mënyra e jetesës</i> (profesionalë, të thjeshtë, pensionistë, persona që punojnë nga shtëpia, adoleshentë me shumë shokë e shoqe)	<i>Mosha</i>	<i>Kërkesat dhe nevojat e tyre</i>

Stili aktual i shtëpisë (përshkrimi): _____

Lloji i ndërtimit apo banesës (shtëpi private, apartament, vilë etj.):

Qëllimi i arredimit: _____

Buxheti në dispozicion për arredimin: _____

Lista e përparësive të arredimit:

1. _____
2. _____
3. _____

Stili i jetës i familjes: _____

Stili i arredimit që do të preferonte vetë familja:

Shtojcë 2. Fletë pune (Veprimtaria nr.2):

Skema e ngjyrave



Shtojcë 3. Fletë pune (Veprimtaria nr.3):

Skema e ngjyrave primare dhe sekondare

Skema e ngjyrave primare



Skema e ngjyrave sekondare

